



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 153, datë 30.11.2017

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2, DATË 28.01.2010
“PËR STANDARDET E RAPORTIMIT DHE TË MBIKËQYRJES SË BYROSË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Neni 14, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Raportimi në Autoritet në lidhje me emetimin dhe furnizimin me polica sigurimi

1. Byroja depoziton në Autoritet, përpara emetimit, specimenet e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

2. Të gjithë policat e sigurimit duhet të përmbajnë numrin serial 9 (nëntë) shifror, ku 2 numrat e parë të korrespondojnë me 2 numrat e fundit të vitit korrent për të cilin emetohen policat e sigurimit të përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Byroja fillon procedurën për emetimin dhe prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm pas dhënies së pëlqimit nga Autoriteti, në përputhje me rregulloret përkatëse të hartuara nga Byroja lidhur me emetimin, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e tyre.

4. Emetimi i policave të sigurimit të detyrueshëm bëhet pas planifikimit duke marrë në konsideratë kërkesat e shoqërive të sigurimit dhe të dhënat e marra nga Autoriteti.

5. Byroja raporton në Autoritet:

- a. Planifikimin e emetimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit për vitin pasardhës, për çdo shoqëri sigurimi, brenda 5 ditëve nga data e përcaktimit të planifikimit përkatës;*
- b. Prodhimin e policave si dhe çdo kërkesë për shtesë për prodhim policash sigurimi brenda 5 ditëve nga data e prodhimit;*
- c. Informacion të detajuar për sasitë e furnizuara sipas numrave serialë të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit për çdo shoqëri sigurimi, brenda 5 ditëve nga dita e furnizimit të shoqërisë së sigurimit.*

2. Pas nenit 14, shtohet neni 14/a dhe neni 14/b me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 14/a
Asgjësimi i policave të sigurimit

1. Byroja çdo vit bën asgjësimin e policave të sigurimit të vitit paraardhës.
2. Byroja, brenda datës 10 janar të çdo viti duhet të hartojë një raport mbi policat e tërhequra nga secila shoqëri sigurimi, policat e përdorura (shitur, anuluar, dublikata, etj.) si dhe policat e pakonsumuara gjatë vitit paraardhës.
3. Raporti duhet të përmbajë:
 - a. Numrin e policave me numrat serialë përkatës, të tërhequr gjatë gjithë vitit nga secila shoqëri sigurimi;
 - b. Numrin e policave që janë përdorur nga secila shoqëri sigurimi (shitur, anuluar, dublikate);
 - c. Numrin e policave të papërdorura (të dëmtuara dhe/ose të papërdorura);
 - d. Diferencën ndërmjet numrit të policave të tërhequra në Byro nga shoqëria e sigurimit me policat e përdorura nga kjo shoqëri sigurimi.
4. Raporti miratohet nga Asambleja e anëtarëve të BSHS.
5. Byroja ia dërgon raportin shoqërive të sigurimit, të cilat brenda datës 15 janar, duhet të dorëzojnë pranë Byrosë listën me sasinë e policave të sigurimit të pakonsumuara nga viti paraardhës.
6. Byroja për policat e sigurimit të pakonsumuara që dorëzohen nga shoqëritë e sigurimit, duhet të mbajë një procesverbal, i cili nënshkruhet nga dy palët:
 - a. dorëzuesi, i cili është person i autorizuar nga shoqëria e sigurimit;
 - b. marrësi në dorëzim, i cili është personi i ngarkuar nga Byroja me marrjen në dorëzim deri në momentin e asgjësimit.
7. Byroja ngre komisione të posaçme për asgjësimin e policave të sigurimit, të përbërë nga 3-5 anëtarë, ku një nga anëtarët duhet të jetë përfaqësues nga Autoriteti.
8. Komisioni i ngarkuar me asgjësimin e policave të sigurimit, pasi bën verifikimin e gjendjes fizike të policave të dorëzuara, mban procesverbal ku evidentohet vendi, data, ora, nr. serial i policave të asgjësuar dhe lloji i policës.
9. Në përfundim të procesit të asgjësimit, Byroja raporton në Autoritet informacion të detajuar për sasinë e policave të asgjësuar për çdo shoqëri sigurimi sipas numrave seriale të policave të sigurimit.

“ Neni 14/b
Dispozitë kalimtare

1. *Emetimi, prodhimi dhe furnizimi me polica të sigurimit të detyrueshëm për vitin 2018, sipas formatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 14, të kësaj Rregulloreje duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2017.*
2. *Policat e sigurimit të detyrueshëm, sipas formatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 14, të kësaj Rregulloreje, do të hidhen në treg duke filluar nga data 01.01.2018. Çdo policë e sigurimit e shitur në kundërshtim me formatin e përcaktuar do të konsiderohet e pavlefshme.*
3. *Policat e sigurimit të detyrueshëm të pakonsumuara në vitet pararendëse të asgjësohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 14/a të kësaj Rregulloreje, brenda datës 31.01.2018.”*